

VENDIM
Nr. 240, datë 2.12.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË
LICENCËS SË SHOQËRISË “HERA” SHPK, NR. 49, SERIA NPM07P, DHËNË ME
VENDIMIN E BORDIT NR. 61, DATË 2.11.2007, “PËR NDËRTIM, INSTALIM,
SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALE ME ERË (PROJEKTI KAPPET)”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3; 17, pikat 1 dhe 4; të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17 .6.2017; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 145/2 prot., datë 25.11.2021, nga Drejtoria e Licencimit, Autorizime dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hera” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për transferimin e licencës nga shoqëria “Hera” sh.p.k., te shoqëria “SOT–AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1083 prot., datë 16.11.2021.

- Kërkesa për transferimin e licencës, vjen për arsye që shoqëria “Hera” sh.p.k., të mundësojë likuiditetet e nevojshme për të përballuar shpenzimet në pritje të vendimit të ERE-s për shtyrjen e afateve për përmbushjen e detyrimeve, siç janë përcaktuar në vendimin nr. 112, datë 26.4.2021 dhe në vijim të aktivitetit të shoqërisë në kuadër të projektit KAPPET.

- Në lidhje me shoqërinë “Hera” sh.p.k., evidentojmë se ajo është në vlerësim të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nga ERE dhe, për këtë arsye, ka kërkuar shtyrjen e afatit të vlerësimit nga ERE. Vendimi përfundimtar i Bordit të ERE-s, për transferimin e licencës, do të merret pas vendimit të Bordit në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimit të licencimit nga shoqëria.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për transferimin e licencës në përputhje me aneksin A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. është themeluar më datë 25.5.2007 dhe është regjistruar në QKB më datë 7.6.2007, është e pajisur me NUIS K71819034H.

- Shoqëria “Hera” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar, me kapacitet të instaluar 150 mw, për një afat 30-vjeçar.

- Shoqëria SOT–AL sh.p.k. është themeluar më datë 4.10.2007 dhe është regjistruar në QKB më datë 9.10.2007 është e pajisur me NUIS K72209002T.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar sipas kërkesave të nenit 17, pikat 1 dhe 4, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

- Neni 17, pika 1 (kërkesë e të licencuarit për transferimin e plotë licencës). Plotësuar.

- Neni 17, pika 4, gerrat “a”, “b”, “c” (në rastin e kërkesës nga i licencuari për transferimin e licencës jo sipas rastit të parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni):

- germa “a” (formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1). Plotësuar.

- germa “b” (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës. Plotësuar.

- germa “c” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës). Plotësuar.

- germa “d” (vërtetimin e pagesës së aplikimit). Plotësuar.
- germa “e” (vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë për miratimin e transferimit të licencës së shoqërisë). Plotësuar.

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. në formatin e aplikimit ka deklaruar transferim edhe për licencën e tregimit dhe furnizimit, në vijim duhet të përcjellë në ERE këtë format të saktësuar, pasi shoqëria është e licencuar vetëm në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Në zbatim të parashikimit të nenit 17, pika 5, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, shoqëria “SOT–AL” sh.p.k. në cilësinë e shoqërisë që kërkon t’i transferohet licenca, duhet të paraqesë në ERE një aplikim sipas pikës 2, të nenit 17, të kësaj rregulloreje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet të instaluar 150 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Vendimi përfundimtar për transferimin e licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. do të merret pasi Bordi i ERE-s të jetë shprehur në lidhje me shtyrjen ose jo të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti